

FJALORTH

Shteti Absolut: Ky term do të thotë se është **vetëm një burim legjitim i pushtetit** dhe në shtete të tilla ishte monarku. Në veçanti, sunduesit e shteteve të tilla janë munduar që t'i eliminojnë asistokracinë dhe Kishën, në mënyrë që të mos i konkurrojnë monarkut. Ky ideal rrallëherë është arritur. Termi **nuk do të thotë** që monarku ka një kontroll të menjëhershëm dhe direkt në jetën e përditshme.

Veprimi pohues: Një mori veprimesh të caktuara apo programe të disennuara që të përmirësojnë shanset e arsimimit dhe punësimit të individëve apo grupeve të cilëve u është ndaluar pjesëmarrja dhe kyçja e plotë në këto fusha.

Anti-Semitizmi: Urrejtja, paragjykimi, shtypja apo diskriminimi kundrejt hebrenjve dhe hebraizimit. Faktikisht, termi është i gabuar. “*Semitik*” do të thotë në mënyrë origjinale pasardhësit e Shem-it, ku përfshihen hebrenjtë dhe myslimanët e Lindjes së Mesme. Tani termi përdoret kryesisht që t'u referohemi hebrenjve.

Apartheid: Apartheid është një fjalë afrikane për diskriminimin sistematik dhe të legalizuar që ekzistonte në Afrikën Jugore në mes viteve 1948 – 94. Nën Aktin e Regjistrimit të Popullsisë së vitit 1950, popullsia ishte klasifikuar në kategori të ndryshme racore, me edukim dhe vendbanim. Edhe martesat ishin e lejuara përbrenda kategorisë së njëjtë. Me zgjedhjen e Nelson Mandelës president, në vitin 1994, sistemi u zhvesh legalisht, edhe pse disa veprime të ngjashme me ato të apartheidit ende vazhdojnë jozyrtarisht.

Arbitrazh(Ligj): Dëgjimi dhe përcaktimi i një mosmarrëveshjeje, në veçanti një mosmarrëveshjeje industriale, ndërmjet dy palëve të ndryshme me anë të një komisioni arbitrazhi (*e drejta ndërkombëtare*), procedura e përcaktuar për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare.

Konflikt i Armatosur: Situata, në të cilën dy apo më shumë grupe të armatosura janë përfshirë në luftë me armë, pa marrë parasysh nëse kjo ndodh në shkallë të brendshme apo ndërkombëtare. Çdo ndryshim që del nga dy shtete dhe që rezulton me ndërhyrjen e forcave të armatosura është konflikt i armatosur, edhe në qoftë se njëra palë e mohon gjendjen e luftës.

Bioetika: Bioetika është studim i çështjeve morale, të cilat rrjedhin nga parimet dhe praktikatat e përgjithshme të shkencave njerëzore. Fusha e bioetikës përfshin ekzaminimin e çështjeve morale të ngritura nga praktikatat shkencore si dhe nga kërkesa filozofike për çështjet e vlerës, dhe hetimin e çështjeve të politikave publike.

Puna e Fëmijëve: Puna e fëmijëve është puna që ua mohon fëmijëve fëmijërinë e tyre, potencialin dhe dinjitetin e tyre, dhe është dëmtuese për zhvillimin fizik dhe mental. Në vitin 1989, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve e KB thërret për mbrojtje *“kundër shfrytëzimit ekonomik dhe kundër bërjes së çfarëdo pune e cila mund të vërë në rrezik mirëqenien dhe shanset e arsimit, apo që mund të jetë e dëmshme për shëndetimin fizik, mental, shpirtëror, moral apo për zhvillimin social.”* (Neni 32).

Pornografia e fëmijëve: Një përshkrim vizuel i një individi i cili është nën moshën 18 vjeçare, apo që duket se është nën moshën 18 vjeçare, i përfshirë në aktin seksual. Përshkrimi vizuel po ashtu mund të shpjegohet si pornografi e fëmijëve, nëse është e reklamuar, promovuar apo prezantuar në mënyrë të tillë që *“krijon përshtypjen”* se materiali përmban përshkrime vizuale për përfshirjen eksplicite të adoleshentëve në aktin seksual. Pornografia e fëmijëve mund të përmbajë videokaseta, fotografi, negative të fotoaparatis apo dosje kompjuterike grafike.

Refugjati fëmijë: Refugjati fëmijë a po fëmija i zhvendosur është çdo person nën moshën 18 vjeçare, i cili kërkon status të refugjatis apo mbrojtje tjetër ndërkombëtare, i konsiderar si refugjat në përputhje me ligjin dhe procedurat e aplikueshme ndërkombëtare apo vendore, pa marrë parasysh se a është i shoqëruar apo i pashoqëruar nga prindërit e tij/saj apo nga ndonjë i rritur tjetër, apo i cili me forcë është detyruar që të

emigrojë përtej kufijve ndërkombëtarë (si rezultat , i luftës, luftës civile, apo dhunës së përgjithshme).

Fëmija: Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e Kombeve të Bashkuara e vitit 1989 e definojnë fëmijën si *“qenie njerëzore nën moshën 18 vjeçare, përveç nën ligjin e aplikueshëm ndaj fëmijës, moshë madhore e të cilit është e arritur më herët”*.

Shoqëria civile: Shoqëria civile i referohet një grumbulli të instituteve, organizatave, dhe sjelljeve të vendosura ndërmjet shtetit, botës së biznesit dhe familjes. Në mënyrë specifike kjo përfshin organizatat vullnetare dhe joprofitabile të shumë llojeve, instituteve filantropike, lëvizjet sociale dhe politike, format e tjera të pjesëmarrjes dhe të përfshirjes, si dhe të vlerave dhe modeleve kulturore të ndërlidhura me to (burimi: shkolla ekonomike e Londrës).

Objekt civil: Çdo objekt i cili nuk është objektiv ushtarake

Civil: Personi i cili nuk është ushtar.

Dëmi kolateral: Dëmi apo humbja e shkaktuar aksidentalisht gjatë një sulmi të ndërrmarë pavarësisht nga të gjitha llogaritjet e nevojshme të disenjuara për të parandaluar, apo eventualisht për të minimizuar humbjen e jetëve civile, lëndimet e civilëve apo dëmin në objekte civile.

Luftëtar: Personi i cili merr pjesë direkte në armiqësi apo anëtar i forcave të armatosura të shtetit apo organizatës së përfshirë në konflikt të armatosur.

Komiteti mbi të drejtën ekonomike, sociale dhe kulturore: Themeluar nga ECOSOC në vitin 1985, funksioni primar i komitetit është që të monitorojë zbatimin e Konventës (KNDESK) nga shtetet. Përpiqet që të zhvillojë një dialog konstruktiv me shtetin dhe kërkon që të përcaktojë nëpërmjet llojllojshmërisë së mjeteve, pa marrë parasysh a gjenden këto norma në konventë (të ndërlidhura për të gjitha nevojat themelore të jetës,

punës, ushqimit, strehimit, kujdesit shëndetësor, arsimimit, dhe kulturës) janë të aplikuar në mënyrë adekuate në këto shtete dhe në ç'mënyrë mund të përmirësohet zbatimi dhe fuqizimi i Konventës, në mënyrë që të gjithë njerëzit që janë të paraparë për të drejtat e shkruara në konventë, të mund t'i gëzojnë ato në tërësi.

Komunikata: Një ankesë individuale apo kolektive ndaj institucionit të marrëveshjes në lidhje me shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut po ashtu thirret “aplikim”, “ankesë”, apo “peticion”.

Ankesa: Një komunikatë individuale apo kolektive ndaj institucionit të marrëveshjes, duke tërhequr vëmendjen për një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Shih po ashtu komunikatën.

Konfidencialiteti: Aftësia për të mbajtur diçka fshehtë. Konfidencialiteti është zgjedhur si një metodë standarde e punës nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, në mënyrë që të bëhet e mundshme një qasje ndaj viktimave dhe t'i mbrojë ato, duke zhvilluar dialog efikas me autoritetet.

Konventa: Traktat multilateral, i cili, nën ligjin ndërkombëtar, është detyrues ndaj të gjitha palëve.

Krimet kundër njerëzimit: Vrasjet, shfarosjet, skllavërimet, depërtimet, burgosjet apo torturat që bëhen si pjesë e një sulmi të gjerë apo sistematik të drejtuar kundër popullatës civile.

Krimet kundër paqes: Planifikimi, pregatitja, nisja apo nxitja e luftës, apo agresionit, ose lufta që shkel traktatet ndërkombëtare.

Të drejtat kulturore: Të drejtat që të ruajë, gëzojë dhe zhvillojë identitetin kulturor të tij.

Deklarata: Një thënie serioze nga një institucion, e cila mund të përmbajë rekomandime por nuk është juridikisht detyruese. Deklarata, po ashtu mund të jetë paraqitje nga shtetet e veçanta për interpretimin e një obligimi.

Teknikat e privimit: Metodatat e torturës psikologjike, përfshirë këtu privimin social apo arsimor, hedhjen në vetmi, privimin nga puna dhe aktivitetet kulturore, politike dhe religjioze, privimi i ndjenjave, privimi i hapësirës fizike, gjumit, komunikimit, higjienës, të të shqyerit, shërbimit mjekësor, etj.

Pakësimi: Ndalesa e një obligimi në lidhje me të drejtat e njeriut me qartësi të caktuar në situata të definuara, siç është emergjenca publike.

I mbajturi : Civil i cili është i akuzuar për një krim dhe mbahet i burgosur gjatë një konflikti të armatosur.

Diskriminimi direkt: Shfaqet kur një person apo grup njerëzish marrin një trajtim më të pafavorshëm sesa një person apo grup në pozicion të njëjtë, të cilët kanë marrë në bazë të racës së tyre, ngjyrës, dhe prejardhjes së tyre nacionale dhe etnike.

Diskriminim: Refuzimi i trajtimit të barabartë të lirive civile, apo mundësive për individë apo grupe në lidhje me arsimimin, banimin, kujdesin shëndetësor, punësimin, apo qasjen në shërbime, në të mira apo ndihma. Diskriminimi mund të shfaqet në baza racore, nacionale, gjinore, moshe, religjioze, politike, apo të bashkimeve etnike, statusit martesorë apo familjar, fizik, në baza zhvillimore, apo të hendikepit mental.

Shkalla e braktisjes: Përqindja e atyre që e lënë shkollën apo universitetin para se t'i kenë mbaruar studimet. Proces i rregullt ligjor: ligji i cili rregullon kahun e administratës nëpërmes gjykatave dhe drejtësisë. Garantimi i procesit të rregullt gjyqësor kërkon që çdo person të ketë mbrojtjen e gjyqimit të paanshëm.

Këshilli ekonomik dhe social: Këshilli i KB i përbërë nga 54 anëtarë, i ndërlidhur parimisht me fushat e popullimit, zhvillimin ekonomik, të drejtat e njeriut dhe drejtësisë së krimeve. Ky institucion i lartë pranon dhe lëshon raporte mbi të drejtat e njeriut në kushte të ndryshme. Shkurtesa ECOSOC.

Të Drejtat Ekonomike: të drejtat e njeriut që kujdesen për prodhimin, zhvillimin, dhe menaxhimin e materialeve për nevojat e jetës.

Arsimimi: Disiplinë që kujdeset, në këtë kontekst, kryesisht me metodat e mësimin dhe të nxënies në shkollat dhe në ambiente shkollore si negacioni i mjeteve të ndryshme jozyrtare të socializimit (p.sh. në mes prindërve dhe fëmijëve të tyre)

Arsimi Fillor: Shkalla e parë e gjetur në edukimin zyrtar, fillon në mes moshës 5 deri 7 dhe përfundon në moshën 11 deri 13.

Sëmundje Endemike: Prezenca konstante e sëmundjes apo agjentëve infektues në një rajon gjeografik; poashtu mund të referohet me përhapjen e një sëmundjeje të caktuar në atë rajon.

Shtatëzanësia e dhunshme: Izolimi i jashtëligjshëm i femrës së lënë shtatëzënë me forcë, me qëllim të ndikimit të përbërjes etnike të çfarëdo pupullate apo bërjen e shkeljeve të tjera të rënda në të drejtën ndërkombëtare.

Prostitucioni i detyruar: Ta detyrosh dikë për prostitucion, dhe përdoret si mjet i konfliktit të armatosur.

Iluminizmi: Një lëvizje intelektuale e cila filloi në Angli në shekullin e shtatëmbëdhjetë, rrënjësuar në një skepticizëm intelektual për besimet dhe dogmat tradicionale, paraqet kontrastin “ilumine” kundrejt karakterit të supozuar të errët dhe bestytnor të mesjetës. Për zanafillën e tij Iluminizmi ishte përqendruar në pushtet dhe mirësinë e racionalitetit njerëzor.

Regjistrim: Akti i bashkimit zyrtar me një kurs, shkollë etj.

Sëmundje epidemike: Sulmojnë dhe dëmton shumë njerëz papritmas në një rajon bashkësie.

Paanësi: Trajtim i drejtë apo i saktë, duke kërkuar raste të ngjashme që janë trajtuar në mënyra të ngjashme.

Spastrim etnik: Zhvendosja me forcë apo shfariosja e popullatave etnike nga një rajon i caktuar në mënyrë që të ndryshojë identitetin dhe të fuqizohet një grup tjetër etnik.

Eurocentrizmi: Proces i vënies së theksit më shumë mbi teoritë dhe idetë evropiane (dhe në përgjithësi perëndimore), në llogari të kulturave të tjera. Nënkuptim i këtij definicioni është supozimi se konceptet perëndimore janë në thelbësisht të ndryshme nga ato të kulturave dhe civilizimeve të tjera. Po ashtu është një nënkuptim kontradiktor i supozimit se konceptet perëndimore janë universale. Kështu, ata kanë evoluar në një përdorim universal kulturor, në të cilin elementet e tjera kulturore lehtë mund të ndërrohen. Është në numër i koncepteve të tilla perëndimore, gjithmonë në proces të vrshimit. Zakonisht idetë e definuara si perëndimore përfshijnë individualizmin, të drejtat e njeriut, autoritetin laik dhe ligjin, si dhe ndarjen e religjionit nga shteti.

Besimi: Një fe, apo cilado bashkësi e besimit fetar.

Gjymtimi Gjenital i Femrës (GJGJF) apo Prerja e Gjenitaleve Femërore (PGJF): GJGJF përmban të gjitha procedurat që përfshijnë heqjen e pjeshme apo tërësore të pjesëve të jashtme të organit gjinor dhe/apo gjymtimin e organeve gjenitale femërore për ndonjë arsye kulturore apo çdo arsye tjetër joterapeutike. (Definicioni i WHO 1995)

Zona e lirë tregtare: Një hapësirë industriale në të cilën shteti i lejon kompanitë e jashtme që t'i importojë materialin për prodhim dhe të eksportojnë të mallra finale pa

paguar taksë dhe detyrime (tatime për qeverinë). Zona e lirë tregtarë, në këtë mënyrë zvogëlon kostot e prodhimit të ndërmarrjes.

Gjinia: Neni 7 Paragrafi 3 i Statutit të Romës për Gjykatën Kriminale Ndërkombëtare e definon gjininë si “*dy sekset, mashkullore dhe femërore, në përbërje të shoqërisë. Termi “gjinia” nuk do të ketë asnjë kuptim nga të lartpërmendurit*”. Definicione më liberale po ashtu mund të përfshijnë pozitat shoqërore lidhur me femra dhe meshkuj.

Modifikimi gjenetik: është një heqje, ndërrim apo lëvizje e gjeneve përbrenda organizimit, si dhe transferi i gjeneve prej një organizmi në tjetrin. Po ashtu mund të nënkuptohet edhe modifikimi i gjeneve ekzistuese apo ndërtimi i gjeneve të reja dhe inkorporimin e tyre në organizëm.

Gjenocidi: Shkatërrimi i qëllimshëm dhe sistematik i një grupi racor, etnik, religjioz apo kulturor përmes vrasjeve, lëndimeve, keqësimit të kushteve jetësore, ndalimit të prejardhjes apo lindjes së fëmijëve.

Horse de Combat (Jashtë betejës): Përkrauan ushtarët të cilët janë kapur apo plagosur apo që janë të sëmurë apo të palëvizshëm, kështu që nuk janë më në pozitë të luftojnë.

Treguesi i varfërisë njerëzore: Treguesi i varfërisë njerëzore i UNDP është zhvilluar si matje e varfërisë, e cila shkon përtej shpërndarjes së më shumë të ardhurave. Pesë atributet kryesore të varfërisë që mund të merren parasysh janë analfabetizmi, mosushqyeshmëria e fëmijëve, vdekja e hershme, kujdesi i keq shëndetësor dhe qasje e dobët në burimet e ujit të pijshëm.

Njerëzia (humaniteti): Natyra njerëzore të të gjithë njerëzve, pa marrë parasysh se kush janë ata, pa marrë parasysh nacionalitetin e tyre, racën, besimin fetar, klasën shoqërore, mendimet politike apo ndonjë karakteristikë grupore apo personale.

Analfabetizmi: Paaftësia e një personi që të lexojë apo të shkruajë.

Paanësia: U ndihmon njerëzve që të marrin vendime për njerëzit, në bazë të nevojave të tyre, pa marrë parasysh nacionalitetin e tyre, racën, besimin fetar, klasën shoqërore apo opinionet politike.

Diskriminimi Indirekt: Përfshin praktikat dhe politikat të cilat mund të shfaqen si “neutrale” apo “ të paanshme”, por që ndikojnë pafavorshëm në një pjesë të madhe të njerëzve të një race, nacionaliteti apo grupi etnik. Gjithashtu, mund të duket se aty nuk ka kurrfarë qëllimi për diskriminim.

Racizmi individual: Formë e diskriminimit racor, i cili rrjedh nga paragjykimet e ndërgjegjshme personale nga individët.

Dialogu ndër fetar: Një tentim për të nxitur dialogun, bashkëpunimin, dhe mirëkuptimin ndërmjet individëve të religjioneve të ndryshme. Dialogët ndërreligjiozë kanë të njëjtin kuptim.

Personi i zhvendosur së brendshmi: Njerëzit që kanë dalë nga shtëpitë e tyre (por nuk e kanë lënë vendin e tyre), nga frika e persekutimit, në mënyrë që t’i shmangen ndikimit të konfliktit të armatosur apo dhunës, shkeljeve të të drejtave të njeriut apo fatkeqësive natyrore apo atyre të bëra nga njeriu.

Organizata (Zyra) Ndërkombëtare e Punës: E themeluar në vitin 1919 si një pjesë e Traktatit të Paqes së Versajës ka qëllim që t’i përmirësojë kushtet e punës dhe të promovojë drejtësi sociale; ONP është bërë agjencion i specializuar i KN në vitin 1946. Shkurtesa ONP.

I internuar: Një civil apo ushtar i cili nuk është akuzuar për krime, por mbahet si i burgosur si masë parandaluese e sigurisë gjatë një konflikti të armatosur.

Intoleranca: Padëshirueshmëria për të rezistuar apo për të respektuar besimet dhe praktikatat e të tjerëve. Intoleranca racore ndalon njerëzit e grupeve të tjera racore që të përdorin bashkë barazinë apo përfitimin e plotë nga shanset e mundshme në bashkësi, përderisa intoleranca fetare refuzon të pranojë apo të respektojë besimet fetare të të tjerëve.

Legjitimiteti: Shkallë në të cilën procedurat qeveritare për bërjen apo fuqizimin e ligjeve janë të pranueshëm për njerëzit. Një sistem i legjitimitetit është legal, po më me rëndësi është që qytetarët i besojnë përshtatjes së tij dhe mbështesin rregullat e tij. Legjitimiteti është i lidhur ngushtë me qeverisjen: pajtimi vullnetar me ligjet dhe rregulloret rezulton në një efektivitet më të lartë dhe besim në pushtet dhe lojalitet personal.

Maquiladora: Një fabrikë, shpesh me pronësi të huaj, që monton të mirat për eksport. Nga fjala spanjolle lexohet mah-kee-lah-doh-ra. Shumë shpesh është e shkurtuar në maquila.

Ndërmjetësim: Një negociatë për zgjidhjen e problemeve, me të cilë pala e tretë punon me të grindurit që t'i ndihmoj për të arritur një marrëveshje të kënaqshme në negociatë. Ndërmjetësuesit nuk kanë kurrfarë autoriteti që të marrin vendim për mosmarrëveshjen ndërmjet palëve; në vend të kësaj palët në negociatë autorizojnë ndërmjetësuesin që të ndihmojë për t'i zgjidhur çështjet ndërmjet tyre.

Domosdoshmëria ushtarake: Koncept nga i cili kuptohet se përdorimi ndërluftues i një shkalle të forcës, i domosdoshëm për të arritur qëllimin e luftës, është i justifikueshëm; qëllimi i luftës, qoftë nënshtimi i plotë i armikut sa më shpejt që të jetë e mundur, me një minimum të humbjeve njerëzore, materiale dhe financiare.

Objektet ushtarake: Objekte të cilat nga natyra, lokacioni, destinimi japin kontribut efektiv për veprime ushtarake dhe shkatërrimi i të cilave ofron një përparësi definitive ushtarake.

Neutraliteti: Mosanimi në konflikt.

Organizata Joqeveritare (OJQ): Është çdo grup i qytetarëve, vullnetar dhe joprofitabil, i cili është i organizuar në shkallë lokale, kombëtare apo ndërkombëtare. OJQ e orientuar në detyra dhe e udhëhequr nga njerëz me interes të përbashkët, kryen një mori shërbimesh dhe funksionesh humanitare, sjell brengat e qytetarëve të qeveritë, avokon dhe monitoron politikat dhe inkurajon pjesëmarrjen politike nëpërmjet dispozitave të informimit.

Joreligjioz: Bota neutrale e pikëpamjeve dhe e besimeve në sferën e mendimit njerëzor, e ndërlidhur me besimet dhe parimet përfundimtare të vetëdijes nga e cila individët jetojnë jetën e tyre.

Ombudspersoni: Institut, zakonisht një zyrtar qeveritar, puna e të cilit është të kontrollojë dhe të raportojë mbi ankesat e bëra nga njerëz të zakonshëm ndaj autoriteteve qeveritare apo publike.

Dokumentet strategjike për vogëlimin e varfërisë: Në vitin 1999, Banka Botërore (së bashku me FMN) kanë paraqitur një koncept të Dokumenteve Strategjike për Zvogëlimin e Varfërisë (DSZV). Këto dokumente janë të dedikuara për përshkrimin e gjendjes makroekonomike të vendit, përfshirë këtu politikat e strukturimit dhe ato sociale. Ato përgatiten nga qeveritë, por ofrojnë një proces të ri të pjesëmarrjes, në mënyrë që të përfshijnë një shumëllojshmëri të gjerë të aksionarëve të shoqërisë civile.

Varfëria: Varfëria karakterizohet nga mungesa e të ardhurave / të hollave dhe burimeve produktive të mjaftueshme që të sigurohet një jetesë solide; mungesa e ushqimit, uria dhe mosushqyeshmëria, shëndeti i sëmurë; rritja e sëmundshmërisë; përfshirja e kufizuar apo mungesa e arsimimit, pastrehueshmëria dhe përjashtimi, si dhe diskriminimi shoqëror.

Paragjykimi: Kornizë mendore e cila priret të paragjykojë një person apo grup në dritë negative. Këto gjykime negative zakonisht bëhen pa ndonjë fakt adekuat. Këto qëndrime

negative shpesh njihen si supozime të njëzëshme, për arsye të frekuencës me të cilën janë përsëritur. Ato bëhen nocione të “ **gjkimit të shëndoshë**” të cilat pranohen në masë të gjerë, dhe përdoren për justifikimin e akteve të diskriminimit.

Të burgosurit e luftës: Ushtarët e kapur në një konflikt të armatosur ndërkombëtar. Vetëm ushtarëve të cilët plotësojnë një kusht të caktuar u është dhënë ky status (në përgjithësi anëtarët e forcave të armatosura).

Proporcionalisht: Parim sipas të cilit humbja e jetëve civile dhe dëmi ndaj objekteve civile nuk duhet të jetë i tepruar në lidhje me përparësinë ushtarake të paraparë nga një sulm në objektiva ushtarake.

Raca: Termi ‘racë’ është një strukturë artificiale, e përdorur për klasifikimin mbi baza të ngjashmërisë fizike dhe kulturore të njerëzve që kanë prejardhje të përbashkët. Shkenca moderne ka treguar se kategorizimi biologjik i racës është i pakuptimtë kur aplikohet në qeniet njerëzore. Qeniet njerëzore biologjikisht, kanë kode të njëjta gjenetike, dhe nuk ka dallime gjenetike ndërmjet të të ashtuquajturave grupe racore apo në mes tyre. Nganjëherë, kjo ideologji është bazë e veprimit shoqëror, themelim i politikës së vendit dhe shpesh një justifikim për trajtim dallues të një grupi ndaj tjetrit.

Racizmi: Një grup i gabuar i supozimeve, mendimeve dhe veprimeve që rrjedhin nga besimi se një grup është më superior sesa tjetri. Racizmi u drejtohet jo vetëm pozicionimeve shoqërore kundrejt pakicave etnokulturore, por edhe strukturave shoqërore të cilat përjashtojnë gupet apo individët e tillë. Racizmi mund të shfaqet në strukturat dhe programet organizative dhe institucionale, si dhe në qëndrimet dhe sjelljet e individëve.

Ratifikim: Procedura nga e cila një shtet, pas arritjes së marrëveshjes me parlamentin, deklaron se është lidhur juridikisht nga traktati.

Rezervim: Paraqitje e bërë nga shteti me rastin e ratifikimit të një traktati, duke përjashtuar apo modifikuar efektet juridike të dispozitave të veçanta mbi shtetin.

Sundimi i ligjit: Sundimit i ligjit mbizotëron qeverinë, mbron qytetarët kundër veprimeve arbitrare të shtetit dhe të shoqërisë në përgjithësi, duke qeverisur marrëdhëniet në mes interesave private. Siguron që të gjithë qytetarët janë të trajtuar në mënyrë të barabartë dhe janë subjekt i ligjit më parë se e tekave (kapriçove) të të fuqishmëve. Sundimi i ligjit është një parakusht thelbësor për përgjegjshmëri dhe parashikueshmëri në sektorin publik dhe privat. Krijimi dhe vazhdimi i sundimit të ligjit varet nga komunikimi i qartë i rregullave, zbatimi që nuk bën dallim, ekzekutimi efektiv, metodat e parashikueshme të ekzekutimit juridik për ndryshim përmbajtësor të ligjit dhe një qytetari që përcepton këtë pako rregullash si të paanshme, të drejta apo legjitime, dhe që është i gatshëm t'i ndjekë ato.

Laik: Është apo është cilësuar si laicizëm; është i ndërlidhur me gjërat e botës të cilat janë të dalluara nga ato të cilat janë të ndërlidhura me religjionin apo fenë. Laicizmi është besim se religjioni dhe çështjet e tij nuk duhet të hyjnë në funksion së bashku me shtetin, në veçanti, në arsimin publik.

Dhuna Seksuale: Sjellje e orientuar në bazë gjinore e cila ka për qëllim të lëndojë apo të vrasë dikë.

Skllavëria: Është identifikuar si një element i pronësisë apo kontrollit mbi jetën e tjetrit, shtrëngim, dhe kufizim i lëvizjes, për faktin se dikush nuk është i lirë të shkojë apo t'i ndërrojë punëdhënësit. Skllavëria e së sotmes nuk është lehtë të identifikohet apo gjendet, për arsye se një masë e saj është e pranuar përbrenda kulturës. Detyrimi me borxhe është praktikuar në shumë pjesë të botës.

Të drejtat ekonomike dhe sociale: Të drejtat të cilat njerëzve u japin siguri ekonomike dhe sociale, nganjëherë të quajtura si të orientuara drejt sigurisë apo të drejta të gjeneratës

së dytë. Si shembuj, mund të merren e drejta për ushqim, e drejta për strehim dhe për kujdes shëndetësor.

Mbyllja në vetmi: Është një mbyllje e veçantë e të burgosurit, me një qasje të rastësishme apo të kufizuar nga njerëzit, në një ambient i cili është i pastruar nga të gjitha mjetet themelore për mirëmbajtje jetësore dhe i cili ka kufizime të dritës, zërit, ushqimit, materialeve të leximit, ushtrimeve dhe nganjëherë edhe temperaturës.

Raportuesi Special: Një individ i emëruar nga një trup në shkallë lokale apo universale si Komisioni mbi të Drejtat e Njeriut i KB që të përgatisë një raport të rregullt mbi situatën e të drejtave të njeriut në një shtet të caktuar, apo mbi një çështje të caktuar të të drejtave të njeriut ("*raportuesi tematik*"). Në qoftë se emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, ai thirret "*përfaqësuesi special*". Një funksion i ngjashëm mund t'i jepet një "*eksperti të pavarur*".

Përfaqësuesi Special: Shih Raportuesin Special.

Programet për Rregullim Struktural: Shumica e kredive të FMN janë të kushtëzuara. Vendi duhet t'i plotësojë një varg kërkesash specifike, në mënyrë që t'i marrë të hollat. Pasi që këto kërkesa, të ashtuquajtura programe të rregullimit struktural, janë shumë të orientuara drejt zvogëlimit të kostos në sektorin shoqëror dhe liberalizimit të tregut, ata shumë shpesh janë kritikuar.

Racizëm i strukturuar: Pabarazitë që rrjedhin nga veprimi i gjerë sistemor i shoqërisë, e cila i përjashton një numër të konsiderueshëm të anëtarëve apo kategori etnike të caktuara nga pjesëmarrja e rëndësishme në institute shoqërore.

Suffragette (Militante e të drejtave të votës): Termi i feministeve amerikano- britanike të cilat luftojnë për të drejtat e femrës e në veçanti për të drejtën e votës.

Zhvillimi i vazhdueshëm: Zhvillimi i cili plotëson nevojat e së tashmes, pa rrezikuar mundësinë e brezave të ardhshëm që t'i plotësojnë nevojat e tyre.

Rehabilitimi nga Tortura: Vendimi për autorizimin e viktimave të torturës që të rifitojnë funksionet, besimin dhe mundësinë që të rifillojnë jetën sa më të kompletuar. Qendrat dhe programet e rehabilitimit adoptojnë dhe zbatojnë një mori të qasjeve të ndryshme të trajtimit, duke marrë parasysh nevojat specifike fizike dhe psikologjike të viktimës së torturës dhe ambientin kulturor, social dhe politik në të cilin ata jetojnë.

Tortura: Çdo akt i cili shkakton dhimbje apo vuajtje, qoftë fizike apo mentale, që qëllimisht shkaktohen mbi personin e arrestuar apo nën kontrollin e akuzuesit. Tortura nuk përfshin dhimbjet apo vuajtjet që rrjedhin vetëm nga pandashmëria nga sanksionet ligjore.

Sindikata: Një organizatë e punëtorëve, e krijuar që të mbrojë dhe përparojë interesin e anëtarëve të tij, duke negociuar marrëveshjet me punëdhënësit për pagat dhe kushtet e punës. Sindikatat po ashtu mund të ofrojnë këshillime juridike, asistencë financiare, përfitime të sëmundjes dhe ndihmesa për edukim. Një sindikatë e pavarur nuk është nën dominimin apo kontrollin e asnjë punëdhënësi dhe financiarisht është e pavarur nga punëdhënësi.

Trafikimi i qenieve njerëzore: Është një lëvizje e ndaluar dhe e fshehtë e njerëzve në kufij kombëtarë dhe ndërkombëtarë, më së shumti nga shtetet në zhvillim dhe nga disa shtete në tranzicion, me një qëllim përfundimtar për detyrimin e femrave, vajzave dhe fëmijëve në situata të shfrytëzimit seksual apo ekonomikisht shtypëse dhe shfrytëzuese për përfitime nga rekrutuesit, trafikantët, sindikatat e krimit, si dhe aktivitetet e tjera ilegale të ndërlidhura me trafikim, siç është puna e detyruar.

Varfëria: Varfëria ka edhe domethënie të tjera përveç stomakut të zbrazur dhe syve të tendosur. Ajo edhe mund të jetë duke punuar varfër – ata të cilët kanë punë, por ende janë të paafte që t'i plotësojnë nevojat e veta.

Ksenofobia: Ksenofobia është urrejtja dhe frika nga të huajt. Kur këto ndjenja janë të shpërndara te një pakicë e dukshme, shprehja ‘racizëm’ përdoret shpesh. Është ndoshta më mirë që të shohin ‘racizmin’ si një rast të veçantë të ksenofobisë dhe pastaj ta përdorin atë lirshëm.